



“DEFEX” SH.P.K,

PERMBLEDHJA JO-TEKNIKE
E RAPORTIT TE VNM-SE



LINJA E PRODHIMIT TE LENDEVE
PLASE PER PERDORIM CIVIL,
"ANFO"

PERMBAJTIA

A) NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR TË MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.....	2
B) INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.....	2
C) NJË IDENTIFIKIM TË NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT.....	3
Ç) NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS.....	3
D) INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA.....	4
DH) TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS,.....	4
E) MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....	4

A) NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR TË MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI.

Zona në studim bëhet pjesë në juglindje të Shqipërisë një sipërfaqe prej 2.180 km² me një lartësi 850 m mbi nivelin e detit. Në mes të tij ndodhet fushgropa e Korçës e rrethuar me male dhe vargje kodrinore . Fushgropa e Korçës si njësi relievi ka një sipërfaqe rrafshnaltë prej 108 km². Forma e fushës i përngjan një pëllëmbë dore e shtrirë në drejtimin veri-jug. Ajo është një prirje dhe futje relieve të rrafshët në drejtim të jugut.

Fushëgropa e Korçës, në të cilën ndodhet objekti që ndërtohet.

Fushëgropa shtrihet midis maleve, përzgjatet në jug gjer në vijën Kamenicë e Pulahë, ku fillon ngritja e relievit dhe rruga automobilistike që ngjitet për në Qafë të Qarrit. Gjerësia më e madhe e rrafshnaltës është në vijën Korçë-Voskop deri në 7,9 km. Në drejtim të veriut fushëgropa shenon një ndarje të saj me hapësirën që mbetet në veri për Bashkinë e Maliqit ku si kufij janë vijat fundore e njësisë administrative e Bulgarecit me fshatra periferike Shamoll e Çiflig deri tek Kuçi Zi në lindje ku largësia e rrafshnaltës lindje perëndim është 8,2 km.

Kjo pllajë përbën sipërfaqen e dytë më të madhe bujqësore të Shqipërisë, ndërsa pjesa më e madhe e saj është një ish-kënetë, e bonifikuar mbas Çlirimit. Një përqindje e madhe e tokës bujqësore përreth Korçës aktualisht është jo plotësisht e shfrytëzueshme, për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe emigracionit të madh.

B) INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Zona e studiuar përshkohet nga kanalet vadites të tokave buqësore. Keto përshkojnë në gjithë fushëgropën e Korçës të cilët u lejon fermerëve vaditjen e tokave të tyre. Rezervuarët kryesorë të furnizimit janë Gjenomadh dhe Lavadar, Gjancit etj. Për fat të mirë rezervuaru i Gjancit nuk është demtuar shumë por demtime kanë pësuar kanalet kryesorë nga 60% -100%. Sasia e ujit për vaditje menazhoet në nivele bashkësisht bujqish. Akuifera ujëmbatese e korçës monitorohet me 4 shpime në akuiferin zhavoror të Kuaternarit dhe një burim në akuiferin karbonatik:

në shpimin nr.3 Turan, nr.1 v I. Terova, nr.108 Bulgarec, nr.173/1 Sheqeras dhe burimi Mancurisht.

• Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet është rreth 465 - 500 L/sek, rezervat më të mëdha shfrytëzohen në Turan. Koeficienti i shfrytëzimit varion $K=0.3-0.5$

Risku i ndotjes është mesatar, favorizuese janë kushtet natyrore të shtrirjes së disa horizonteve ujëmbajtëse në thellësi të ekranizuar ndërmjet tyre me shtresa argjilore. I vetmi burim sipërfaqësor ndotjeje mund të jetë lumi i Dunavecit nga krahu juglindor i akuiferit, kryesisht për horizontin e parë ujëmbajtës i cili si rregull nuk shfrytëzohet.

Rezultatet e monitorimit

Monitorimi i cilësisë së UN në këtë akuifer u krye me 4 shpime: Turan, ish-ferma I. Terova, Bulgarec dhe Sheqeras. Janë kryer 15 analiza kimike dhe 3 analiza për mikroelemente. Duke parë rezultatet e analizave të kryera gjatë vitit 2014 rezultoi se UN në këto zona kanë veti fiziko-kimike e kushteve higjieno-sanitare të mira. Ujrat janë pa erë, pa ngjyrë, pa shije.

Qyteti i Korçës aktualisht është i lidhur me një sistem të integruar ujërash të zeza dhe kullimi nëpërmjet tubacioneve të konsoliduara, pa pasur sistem veçmas për ujërat e zeza dhe veçmas për

kullimin. Sistemi I integruar konsiderohet si problematik pasi kërkon mbingarkesë të panevojshme të rrjetit të kanalizimeve dhe të impiantit të trajtimit të ujërave të mbetura. Pra, Korça duhet të vijojë me ndarjen e sistemit të kanalizimeve nga sistemi i drenazhimit, duke ndërtuar një sistem të ri drenazhimi nën tokë. Tipografia unike e Korçës do të jetë faktori përcaktues i sistemit të kullimit të qytetit.

C) NJË IDENTIFIKIM TË NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT.

Ndikimet e identifikuar nga zhvillimi i aktivitetit janë ndikime direkte në mjedis.

Tabela e identifikimit të ndikimeve të mundshme negative në tokë.

	Ndikimi i mundshëm	Sqarim
1	Derdhja pa dashje e vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punës.	<i>Behet fjale për ndonjë rast të rralle të rrjedhjes gjatë difekteve dhe çarje të tubave dhe sotokartit të mjeteve motorike dhe ndërrimit të vajrave në makinerite e karreres gjatë prodhimit dhe transportit të mineralit.</i>

Tabela e identifikimit të ndikimeve të mundshme negative në ajër.

	Ndikimi i mundshëm	Sqarim
1	Shkarkimi i gazeve në sasi minimale nga lenda djegëse	<i>Sasia e gazeve nga djegia e karburantit që do të shkarkohet nga mjetet motorike. Është standart i teknologjise së prodhimit të mjeteve dhe i karburantit.</i>
2	Emetimi i zhurmave nga puna e makinerive .	<i>Vlerat standart të emetimit të zhurmave sipas teknologjise së prodhimit të makinerive, kontroll teknik të makinerive.</i>

Tabela e identifikimit të ndikimeve të mundshme negative në biodiversitet.

	Ndikimi i mundshëm	Sqarim
1	Shqetësim i mundshëm i faunes.	<i>Ndikim i perkoshëm.</i>

Ç) NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS.

Gjatë ndërtimit të Linjes së prodhimit të ANFO-s , do të ketë ndryshime të vogla në topografinë lokale. Në projekt është parashikuar një radhë për nivelimin e zonës ku do të vendosen linja e prodhimit si dhe të shërbimit. Për shmangien dhe parandalimin e erozionit si dhe për ruajtjen e regjimit të rrymës së ujit të parametrave hidrodinamike të saj, në projekt është përcaktuar edhe ndërtimi i kanaleve perimetrike për grumbullimin dhe rrjedhjen e tyre .

Në fazën përfundimtare sipërfaqja në të cilën do të ndërtohet nuk duket nga qendrat e medha të banuara , me përjashtim të rasteve të kalimtareve që udhetojnë në rrugën pranë. Projekti

Arkitektonik është hartuar në zbatim të legjislacionit me fuqi dhe ka një sipërfaqe të gjelber prej 2383 m².

Sipërfaqja e tokës ku mendohet të ndërtohet nuk ka ndonjë përdorim apo status të vecantë. Përse i përket aktivitetit që do të zhvillohet ai konsiston vetëm në prodhimin e ANFO-s dhe nuk do të ketë ndikime shtesë. Është për tu theksuar se lëndë e parë përdoret Nitrati Amonit ndryshe Plehu Kimik.

Zhvillimi i aktivitetit do të sjellë emetime të pluhurave në mjedis gjatë ndërtimit të objekteve industriale dhe materialit të germur të sipërfaqes së tokës. Gjithashtu djegia e lëndës djegëse që do të vijë vetëm nga automjetet që do të frekuentojnë këtë ambient si dhe në rastet e rralla kur ka mungesë të energjisë elektrike dhe do të lindë nevojë për ndëzjen e gjeneratorit.

Gjatë fazes normale të operimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazeve, lëngjeve, mbetjeve toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin përreth, florën dhe faunën e zonës, burimet ujore. Ushtrimi i aktivitetit në këtë sipërfaqe nuk ndikon negativisht në cilësinë e mjedisit.

D) INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA.

Ne rastin tone ndikimi në kohëzgjatë I linjës së prodhimit është kryesisht vetëm në fazën e ndërtimit.

Pasi objektet industriale të ndërtohen nuk do të ketë shkarkime në mjedis sepse linja e prodhimit të anfos është një proces perziesh të lëndëve të para (Nitrati Amonit me Naftë) duke i kthyer ato në produkt përfundimtar. Produkti përfundimtar, ANFO largohet nga linja e prodhimit dhe magazinohet sipas legjislacionit në fuqi në depot që zoteron Shoqëria "DEFEX" shpk.

DH) TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS,

Ndikimet e parashikuara nuk kanë shtrirje të madhe fizike, Linja e prodhimit ndodhet në distancë të konsiderueshme nga zona me e afert e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i këtij aktiviteti. Zhurmat që krijohen gjatë fazës së ndërtimit nuk përbejnë ndotje akustike. Analiza e frekuencës të zhurmës të emetuar nga këto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nën mesataren e frekuencës 100 – 150 Hz, e cila është e pranueshme nga veshi i njeriut. Koha në të cilën do të jenë të pranishme këto zhurma është vetëm gjatë ditës, meqenëse në objekt do punohet vetëm me një turn. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve në largësi nuk do të jetë i madh dhe do të jetë konform normave në fuqi.

E) MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Referuar natyrës së procesit nuk kemi sasi gazesh të shkarkuar në atmosferë, Gazet prej mjeteve të punës janë në intervale kohore të shkurtra, brenda normave të lejuara pa ndonjë ndikim negativ në mjedisin përreth. Këto lloj mjeteve emetojnë sasira gazesh të cilat janë rezultat i punës së motorrave me djegie të brendshme, brenda normave të lejuara. Këto mjete para se të vihen në punë janë objekt i kontrolleve teknike vecanërisht për emetimet e gazta.

Per mbrojtjen nga gazet e motorreve dizel do te merren keto masa :

1. Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore.
2. Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.
3. Meqenese qendrat e banuara jane ne nje distance relativisht te konsiderueshme nga zona e ku do te ndertohet linja e prodhimit keto emetime nuk ndikojne ne to.
4. Per zbutjen e ketyre ndikimeve punonjesit do te pajisen edhe me mjete mbrojtese.

Zhurmat qe krijohen vijne nga levizja e makinerive, jane te pranishme por nuk perbejn rrezik dhe shqetesim per mjedisin sepse zonat e banuara jane ne nje distance te konsiderueshme. Per mbrojtjen nga zhurma te njerezve nga ana e shoqerise do te punohet ne dy drejtime

- Ne linje do te perdoren makineri dhe pajisje te teknologjise se larte te pajisura me amortizues te zhurmave
- Punonjesit do te pajisen me mjete mbrojtese sipas rregullores se sigurimit teknik.

Masat qe do te merren per zbutjen e ndikimit gjate fazes se FUNKSIONIMIT

- Per shkarkimin e ujrave te objekteve si zyra , dushe - garderobe shoqeria do te realizoj piken e lidhjes me rrjetin e kanalizimeve te ujrave te zeza te qytetit te Korces. Qyteti i Korces ka nje sistem te integruar ujerash te zeza dhe kullimi nepermjet tubacioneve te konsoliduara.
- Mbetjet qe do te prodhohen nga konsumi i perditeshme ne kete objekt do te jene mbetje te ngurta si plastike, shishe qelqi , materiale letre, mbetje organike etj te gjeneruara nga puntoret dhe administrata e Linjes se Prodhimit. Ne kompleksin e Linjes se Prodhimit do te kete vende te caktuar per ndarjen e mbetjeve ne dy grupe , Organike dhe Jo-Organike

Mënyrën e ndarjes së mbetjeve dy kazanë prej 1,7m³, plastik, hermetikisht të mbyllur që mund të futesh, jo të tërheqësh prapa, ku njeri do të jetë për mbetjet e thata (plastikë, karton, letra, qelq, metalike) e tjetri për mbetjet e njoma (kuzhine, organike). Mbetjet ne bashkepunim me bashkine e Korces dhe firmen pastruese te zones do te largohen per ne vendin e caktuar.

Faza	Problem mjedisor/Receptoret Mjedisor	Ndikimi
Faza e Ndertimit	Cilesia Mjedisore e tokes	<i>Ndikim Negativ</i>
	Perdorimi I tokes/transferimi I siperfaqeve	<i>Nuk ka Ndikim</i>
	Degradimi fiziko biologjik I tokes	<i>Ndikim Negativ</i>
	Biodiversiteti	<i>Ndikim Negativ</i>
	Cilesia e Ujerrave	<i>Ndikim Negativ</i>
	Cilesia e Ajrit	<i>Ndikim Negativ</i>
	Zhurmat	<i>Ndikim Negativ</i>
	Peisazhi	<i>Ndikim Negativ</i>
	Menaxhimi I mbetjeve	<i>Ndikim Negativ</i>
	Transporti	<i>Nuk ka Ndikim</i>
	Zhillimi I bisnesit	<i>Nuk ka Ndikim</i>
	Permbytjet	<i>Nuk ka Ndikim</i>
	Cilesia e Jetese dhe rekreavitetit	<i>Nuk ka Ndikim</i>
Funksionimi	Cilesia Mjedisore e tokes	<i>Ndikim Pozitiv</i>
	Perdorimi I tokes/transferimi I siperfaqeve	<i>Nuk ka Ndikim</i>
	Degradimi fiziko biologjik I tokes	<i>Ndikim Pozitiv</i>

	Biodiversiteti	<i>Ndikim Pozitiv</i>
	Cilesia e Ujerave	<i>Ndikim Pozitiv</i>
	Cilesia e Ajrit	<i>Ndikim Pozitiv</i>
	Zhurmat	<i>Ndikim Pozitiv</i>
	Peisazhi	<i>Nuk ka Ndikim</i>
	Menaxhimi I mbetjeve	<i>Ndikim Pozitiv</i>
	Transporti	<i>Ndikim Pozitiv</i>
	Zhillimi I biznesit	<i>Ndikim Pozitiv</i>
	Permbytjet	<i>Nuk ka Ndikim</i>
	Cilesia e Jetese dhe rekreavitetit	<i>Ndikim Pozitiv</i>

Pergatiti

"Studime Projektme Minerare"

**Licensuar nga Q.K.B per sherbime ekspertize profesionale lidhur me ndikimin
ne mjedis**

License Nr. LN-7543-02-2014

Inxh. Halil BULICA

Inxh. Denis STASA

Inxh. Hysen DOÇI

